L I G J
Nr.8222, datë 14.5.1997

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1997

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
BUXHETI I PËRGJITHSHËM

Neni 1

Buxheti i shtetit i vitit 1997 të jetë:
- të ardhurat 65 530 Milionë lekë
- shpenzimet 126 388 Milionë lekë

Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore i vitit 1997 të jetë:
a) Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

- të ardhurat gjithsej 18 730 Milione lekë
* nga kontributet 9 817 Milione lekë
* transferime nga buxheti i shtetit 8 913 milionë lekë

- shpenzimet 20 160 Milione lekë

b) Skema e sigurimit suplementar
- të ardhurat gjithsej 44 milionë lekë
* nga kontributet 15 milionë lekë
* transferime nga buxheti i shtetit 29 milionë lekë
- shpenzimet 44 milionë lekë

Neni 3

Buxheti i sigurimeve shëndetësore i vitit 1997 të jetë:
- të ardhurat 1584 milionë lekë
* nga kontributet 794 milionë lekë
* transferime nga buxheti i shtetit 790 milionë lekë
- shpenzimet 1584 milionë lekë

KREU II
BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Neni 4

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore të jenë:

-të ardhurat nga fondi kundërparti	1 300	milionë lekë
-të ardhura tatimore	34 800	milionë lek
- të ardhura jotatimore	12 430	milionë lek
- ndihma të huaja për projekte	17 000	milionë lekë

Neni 5

Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burimet e brendshme të jetë 44 473 milionë lekë. Kufiri i financimit me kredi të huaja të jetë 17 815 milionë lekë.

Neni 6

Deficiti i buxhetit të sigurimeve shoqërore, si dhe zhbalancimi i mundshëm gjatë gjithë vitit i buxhetit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të financohet nga fondi i garantimit të pensioneve.

KREU III
SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 7

Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore të jenë:

- Shpenzime korrente	79255 milionë lekë
- Shpenzime kapitale	44093 milionë lekë
- Rezervë e KM	1500 milionë lekë
- Kontigjencë	1540 milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion qendror, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pa kushtëzuara, të jetë sipas pasqyrës nr.1 të bashkëngjitur.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të përdoret proporcionalisht sipas tremujorëve për periudhën e mbetur.

Neni 8

Në zërin fonde të kushtëzuara përfshihen shpenzimet nga financimet e huaja për projekte dhe nga të ardhurat që me ligj ose akte nënligjore u takojnë institucioneve buxhetore. Këshilli I Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Financave, përcakton llojin e të ardhurave që me akte nënligjore do t'u lihen në përdorim institucioneve buxhetore, si dhe kriteret e përdorimit të tyre në përputhje me kufijtë e vendosur në këtë ligj. Fondet e kushtëzuara, me përjashtim të financimeve të huaja dhe të të ardhurave të pushtetit lokal, krijohen dhe përdoren brenda vitit buxhetor.

Neni 9

Fondi i kontigjencës përdoret për shpenzime që nuk mund të parashikohen dhe përfshihen aktualisht në buxhetin e secilës ministri, si dhe për ruajtjen e deficitit buxhetor. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përdorimin e këtij fondi, me përjashtim të pjesës së caktuar për ruajtjen e kufirit të deficitit buxhetor prej 1000 milionë lekësh.

Neni 10

Shpenzimet kapitale nga burime të brendshme të jenë 9278 milionë lekë dhe nga burime të huaja 34 815 milionë lekë. Lista e përmbledhur e objekteve të jetë sipas pasqyrës nr.2 të bashkëngjitur.

Neni 11

Shpenzimet korrente dhe shpenzimet për investime për pushtetin gjyqësor të jenë sipas pasqyrës nr.3 të bashkëngjitur.

Neni 12

Kufiri i shpenzimeve sipas pasqyrave nr.1, 2 dhe 3 mund të rishpërndahet gjatë vitit midis institucioneve dhe objekteve nga Këshilli i Ministrave, deri në masën 10 për qind të totalit të fondeve të parashikuara për çdo institucion dhe objekt. Për objektet e investimeve ky kufizim është i vlefshëm vetëm për ato që financohen me burime të brendshme. Nuk lejohet përdorimi i fondit të pagave për qëllime të tjera.

KREU IV
DISPOZITA TE TJERA

Neni 13

Kriteret e ndarjes dhe përdorimit të të ardhurave nga tatimi mbi pasurinë do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin nr.8054, datë 30.12.1995 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1996", ndryshuar me ligjin nr.8172, datë 21.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8054, datë 30.12.1995".

Neni 14

Nëse plani i të ardhurave nuk realizohet në masën e parashikuar në buxhetin e vitit 1997, shpenzimet do të ulen në të njëjtën masë nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave dhe pas miratimit nga Kuvendi Popullor.

Neni 15

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

KREU V
BUXHETI FAKTIK 1995

Neni 16

Miratohet buxheti faktik për vitin 1995 dhe burimet e tij të financimit si vijon:

- të ardhurat	54 408	milionë lekë
- shpenzimet	74 153	milionë lekë
- deficiti	19 745	milionë lekë
- financimi i deficitit		
- kredi nga Banka e Shqipërisë	5 572	milionë lekë
- bono thesari	11 028	milionë lekë
- kredi e huaj neto	4 672	milionë lekë
- ndryshim i gjendjes së arkës	-1 527	milionë lekë

KREU VI
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 17

Çdo akt ligjor e nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi më 14.5.1997 dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1997.

Shpallur me dekretin nr.1803, datë 26.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha